



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:050987

Datë: 22.11.2021

Numri i dokumentit: 02425322

C.nr.1008/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunatoren profesionale Albinë Velekinca-Sadiku, në çështjen juridike të paditësit K.Q nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Shaqiri avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson Burim Maliqi, Zyrtar Ligjore në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti shpërblimi jubilar dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e objektit: 4,585.50 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jopublik/ për shkak të pandemisë Covid -19/ të mbajtur me datë 16.11.2021, merr këtë;

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar me ligj kërkesëpadia e paditësit K.Q nga Gjilani dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 924.00€, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 16.04.2021 për 462 ditë të pranisë në punë, pastaj kompensimin në emër të kualifikimit/grades/ për periudhën 18.04.2017 deri më 31.12.2020 shumën prej 3,432.00€ si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës në vlerë të 50% të një page bazë 229.50€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 4,585.50€, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 17.04.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 270 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi K.Q nga Gjilani, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim Av. Ilir Shaqiri nga Gjilani, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor të datës 16.11.2021 ka bërë zgjerimin e padisë në kuptimin e objektiv, ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 924.00€, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 16.04.2021 për 462 ditë të pranisë në punë, pastaj kompensimin në emër të licencimit për periudhën 18.04.2017 deri më 31.12.2020 shumën prej 3,432.00€ si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës në vlerë të 50% të një page bazë 229.50€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 4,585.50€, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 17.04.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij

Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës, 270.00€.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës, në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si dhe ndryshimin e saj si të pabazuar me ligj, duke theksuar se Gjykata Themelore në Gjilan nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, po ashtu ka theksuar se Komuna e Gjilanit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë nënshkrues të Kontratës së lartcekur janë MASHT-i/ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ dhe SBASHK-u/ Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës/ dhe se kontrata kolektive nuk prodhon efekte juridike për të paditurin, ngase e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës. Po ashtu i njëjti ka kundërshtuar edhe sa i përket pagës jubilarë me arsyetimin se një e drejtë të tillë është dashur të bëhet nga i padituri në afat prej 30 ditësh nga koha e të drejtës për këtë kompensim dhe për këtë kemi tejkallim të afatit ligjorë për realizimin e kësaj kërkesë.

Gjykata analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar me ligj, ashtu që Gjykata ka vendosur si në diapozitiv të Aktgjykimit duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 924.00€, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 16.04.2021 për 462 ditë të pranisë në punë, pastaj kompensimin emër të licencimit për periudhën 18.04.2017 deri më 31.12.2020 shumën prej 3,432.00€ si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë të punës në vlerë të 50% të një page bazë 229.50€, respektivisht shumën e përgjithshme prej 4,585.50€, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data 17.04.2020/ data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Kërkesat e paditësit bazën ligjore e kanë në nenin 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / *Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017*/ ku në bazë të nenit 35 paragrafi 7 dhe 8/1 dhe në bazë të neni 7 paragrafi 1/4 të Kontratës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se *„të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë mardhënie e punës primare në institucionet arsimore. Ndërkaq sa i përket shpërblimit jubilar në mënyrë shprehimore është paraparë në nenin 8 paragrafi 8.1 e të njejtës kontratë ku është përcaktuar se: Punëtorët (antarë të SBASHKUT-ut) në vitin jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënsi i fundit, në vlerë: për 10 vite të përvojës së punës shpërblimin prej 50% të një page bazë. Ndërsa sa i përket licencimit (gradimit) në mënyrë shprehimore është paraparë në nenin neni 7 paragrafi 1/4 e të njejtës kontratë ku është përcaktuar se: Me licencim fitohet e drejta për punë, të avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të Arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë mësimdhënësi me diplomë 5 vjeçare, magistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë.*

Në fakt në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është mësimdhënës në shkollën e artit Pamor “A.K ” në Gjilan për periudhën prej 06.06.2012 e në vazhdimësi dhe ka 462 ditë pune, ngase një fakt të tillë e konfirmonë Kontrata e Punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me nr.prot. 1352 të dt.01.09.2015, ku është përcaktuar se paditësi ka përvojë të punës mbi 10 vite,

Po ashtu në bazë të Vërtetimeve nr. 102/2020 të dt.26.05.2020 vërtetohet se paditësi për periudhën kohore nga data 17.04.2017 e në vazhdimësi ka qenë i pranishme në punë për 329

ditë, kurse në bazë të vërtetimit me numër 84/21 të datës 22.10.2021 të lëshuar nga Shkolla e Muzikës në Gjilan, nga periudha 14.09.2020 deri 16.04.2021, ka qenë i pranishëm në punë për 28 ditë, kurse në bazë të vërtetimit me numër 35/20 të datës 04.03.2020 të lëshuar nga Shkolla e Muzikës në Gjilan, nga periudha 18.04.2017 deri 04.03.2020, ka qenë i pranishëm në punë për 105ditë, nga Vërtetimi me numër protokoll62/2021 të datës 22.10.2021, vërtetohet se paditësi ka përvojë të punës prej 06.06.2012 e në vazhdimësi, nga diploma me numër 12-7/8 me datë 06.03.2013 dhe licenca me numër 100001011 e datës 11.09.2012, të lëshuara nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, gjykata vërtetoi faktin se i nijeti ka të kryer masterin dhe licencën.

Sipas pretendimeve të palëve ndërgjyqës nuk ka qenë kontestuese lartësia prej (2)€ e pagesës së shujtave ditore, si dhe prania e mësimdhënësës në punë për 459 ditë, por kontestuese sipas të paditurës mbeten faktet, nëse Kontrata Kolektive e lartcekur prodhon efekt juridikë për të paditurën, meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj si dhe kërkesa a është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet në nenin 82 të Ligjit të Punës si dhe ditët e pranisë në punë për vitin 2019.

Poashtu, kontestuese në mes palëve ndërgjyqës mbeten faktet nëse kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, pastaj nëse Kontrata Kolektive e lartcekur prodhon efekt juridikë për të paditurën meqenëse nuk është nënshkruar nga ana e saj si dhe ditët e pranisë në punë për vitin 2019 ngase ka më tepër ditë të shënuara se sa që janë të parapara në kalendar të vitit shkollor.

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligjinr. 06/L – 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Kurse Departamenti për Qeshje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon qeshjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktin administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtoreve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ marrëdhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës e më pastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për Qeshje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurs siç dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017/, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunale apo DKA-të.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimin e të paditurës ku ka theksuar se paditësi fillimisht nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi në gjykatë, mirëpo për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, pasi që, në bazë të shkresave të lëndës dhe provave të administruara, përkatësisht nga Kërkesa me numër 05-610/01-0030818/20 të datës 17.04.2020, rezulton se paditësi fillimisht iu ka drejtuar me kërkesë te paditurës për realizimin e të drejtës së tij, por e paditura nuk iu ka përgjigjur kërkesës së paditësit. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se meqë e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet

punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësi brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, mirëpo kjo nuk nënkupton se paditësi nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shterur mjetet juridike të e paditura ashtu siç pretendon e paditura, kjo ngase e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditësit në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë. Lidhur me pretendimet e të paditurës se paditësi nuk është anëtar i SBASHKUT gjykata një pretendim të tillë e refuzoi me arsyetim se në nenin 35 paragrafi 7 që ka të bëjë me shpenzimet e ushqimit dhe kompenzimin në emër të licencimit dhe nenin 35. par.8 dhe neni 7.par.1/4,që ka të bëjë me pagesën e shpërblimit jubilar të Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar nuk është paraparë se Punëtorët arsimor duhet të jenë anëtarë të SBASHK-ut, e po ashtu edhe në nenin 5 të Ligjit të Punës Ligji nr.03/L-212 që ka të bëjë me ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit e në rastin konkret edhe pse i njëjti nuk është anëtar i SBASHK-ut të njëjtit i takojnë shpenzimet e ushqimit dhe të shpërblimit jubilar konform Ligjit të Punës.

Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga Gjykata konformnenin 382 të LMD/ Ligjinr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012, në të cilën dispozitë është përcaktuar se *„ Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, Gjykata e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së, duke marur parasysh suksesin e paditësit në kontest, ashtu që e detyroi të paditurën që t’ia kompensojë paditësit shpenzimet në lartësi prej 270€, në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi edhe ate për përpilimin e padisë shumen prej 104€, taksa gjyqësore në lartësi prej 21€ dhe për një përfaqësim gjyqësor të avokatit 135 €.

Nga të cekurat më lartë, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:050987, 16.11.2021

G j y q t a r i,
Berat Spahiu

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:050987
Datë: 22.11.2021
Numri i dokumentit: 02425322